



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:044640

Datë: 06.07.2022

Numri i dokumentit: 03204713

**P.nr.96/22**

**P.nr.105/22**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. Gj. nga Gjakova, për shkak të veprave penale vjedhje në neni 313 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës të PTH-DP në Gjakovë PP/II.nr.332/22 të datës 04.03.2022 kundër të akuzuarve A. Gj. dhe S. M. që të dy nga Gjakova për shkak të veprës penale vjedhje në bashkëkryerja nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së sipas aktakuzës PP/II.nr. 1807/22 të datës 09.03.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë **04.07.2022** në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, të dëmtuarit M. Zh., mbrojtësit të akuzuarit av. Genc Juniku dhe të akuzuarve A. Gj. dhe S. M., me dt.06.07.2022, mori dhe publikisht shpalli, ketë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. GJ.** nga Gjakova, Rr". . ." nr. . . , data e lindjes . . . në Gjakovë, i biri i S. dhe i nënës V. e gjinisë H., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, i pa punë, i martuar atë i 2 fëmijëve, shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës, ID . . .

I akuzuari **S.V.** nga Gjakova, Rr ". . ." "nr. . . ,data e lindjes . . . , i biri i M. dhe i nënës S. e gjinisë Sh., ka te kryer shkollën e fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

#### I. PJESA NDESHKUESE .

I akuzuari A. Gj. :

#### Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

I.

-me dt.28-29.03.2021, në kohë të pacaktuar, në Gjakovë në rr. ". . .", me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vete, i'a merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit B.B. nga Gjakova, në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike shkon në punëtorinë e të dëmtuarit dhe duke shfrytëzuar mos prezencën e askujt, depërton brenda dhe nga aty vjedh pajisje të punës, konkretisht një fleks "Dewalt", prodhim USA, burma shinë dhe një akumulator, e më pas

largohet nga aty pa u vërejtur nga askush, me ç ‘rast me dt.30.03.2021, nga ana e zyrtareve policor një fleks dhe burma shinë sekuestrohen tek dëshmitari V. B. dhe të njëjtat i kthehen të dëmtuarit, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton dem në vlerë prej 63 Euro.

- me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

## II.

- Gjatë muajit Mars të vitit 2021 në kohë të pacaktuar në Rr.”. . .” në Gjakovë, në bashkëveprim me njëri tjetrin e me qëllim që vetit t’i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë marrë sendin e luajtshëm pronë e të dëmtuarit M. Zh., në atë mënyrë që të pandehurit pasi kanë ndarë rolet mes veti dhe kanë shkuar në vendin e lartë cekur, e vërejnë veturën e tipit . . .kadet, ngjyre e kuqe, me targa . . . , e cila nuk kishte qenë e mbyllur me qelës dhe të njëjtit pasi afrohen e hapin bagazhin e veturës dhe aty marrin një mjet të punë – burma shinë të tipit Rockwel në vlerë prej 80 Euro, ndërsa ky mjet më pas sekuestrohet nga policia dhe me datë 16.04.2021 i kthehet të dëmtuarit.

- me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

**Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 , 72, si dhe nenit 313 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin A. Gj. , e gjykon**

- Për veprën penale të përshkruar në piken e I-rë, të dispozitivit të aktgjykimit vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre ) muaj**, si dhe dënim me gjobë ne shumë prej **100.00 (njëqind) euro**,

- Për veprën penale të përshkruar në piken e II- të, të dispozitivit të aktgjykimit vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) muaj**, si dhe dënim me gjobë ne shumë prej **100.00 (njëqind) euro**,

**Gjykata bazuar ne nenin 76 te KPRK-së, të akuzuarin :**

## E G J Y K O N

Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre ) muaj** ,si dhe

Dënim me gjobë ne shumë prej **200.00(dyqind) euro**, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë .

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas neni 43 të KPRK-së, atëherë i njëjti do t’i zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej **10(dhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20(njëzet) €**.

Të dëmtuarit B.B. dhe M. Zh., që të dy nga Gjakova,për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej 30,00 €, si dhe në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20.00 €, në afat prej 15 ditëve ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë .

## II. PJESA NDESHKUESE .

**I akuzuari S. M.;**

**Bazuar në nenin 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së:**

### **REFUZOHET AKUZA**

Se:

- **Gjatë muajit Mars të vitit 2021 në kohë të pacaktuar në Rr.”. . .” në Gjakovë**, në bashkëveprim me njëri tjetrin e me qëllim që vetit t’i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë marrë sendin e luajtshëm pronë e të dëmtuarit M. Zh., në atë mënyrë që të pandehurit pasi kanë ndarë rolet mes veti dhe kanë shkuar në vendin e lartë cekur, e vërejnë veturën e tipit . . .kadet, ngjyre e kuqe, me targa . . ., e cila nuk kishte qenë e mbyllur me qelës dhe të njëjtit pasi afrohen e hapin bagazhin e veturës dhe aty marrin një mjet të punë – burma shinë të tipit Rockwel në vlerë prej 80 Euro, ndërsa ky mjet më pas sekuestrohet nga policia dhe me datë 16.04.2021 i kthehet të dëmtuarit.

**-me çka do të kishte kryer veprën penale vjedhje në bashkëkryerje nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

- Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.332/22 të datës 04.03.2022, ka akuzuar të akuzuarin A. Gj. nga Gjakova , për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së si dhe me aktakuzën P/II.nr.1807/21 të datës 09.03.2022., ka akuzuar të akuzuarit A. Gj. dhe S. M., që të dy nga Gjakova , për shkak të veprës penale vjedhje në bashkëkryerje nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , duke propozuar/ që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit dhe të obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjykata gjatë shqyrtimit të mbajtur me dt. 04.07.2022, sipas propozimit të mbrojtësit të akuzuarit A. Gj. av. Genc Juniku dhe pëlqimit të prokurorit të shtetit, për bashkimin e lëndëve penale P.nr. 96/22 dhe P.nr. 105/22 dhe zhvillimin e përbashkët të procedurës penale për këto 2 lëndë penale, ka bërë bashkimin e këtyre 2 lëndëve penale dhe shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me numër unik P.nr.96/22

Gjatë shqyrtimit të fillestar t[ë mbajtur me datë 04.07.2022 , përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë Prokurori shtetit Anton Hasanaj ,lexon aktakuzën PP.nr.332/22 të datës 04.03.2022 , me ç ‘rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës sa i përket të akuzuarit A. Gj..

I akuzuari A. Gj. ,duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin tim av. Genc Juniku, e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer , kërkojë falje nga i dëmtuari për demin e shkaktuar edhe pse gjësende i janë kthyer të dëmtuarit, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , andaj i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se ne të ardhmen do të jem me i kujdesshëm dhe nuk do të përsëris një veprim të tillë , të me shqiptojë një dënim me të butë.

Mbrojtësi av. Genc Juniku, deklaroi se e mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im për veprën penale të kryera ,të cilën pranim i njëjti e bere pa kanosje apo ndërhyrje por me vet iniciativ duk e i ditur edhe me par pasojat dhe favoret e pranimi të fajësisë .I propozoi gjykatës qes me rastin e

caktimit llojit dhe lartësisë së dënimit të njëjtit ti shqiptojë një dënim me të butë i cili kishte me arrit qëllimin e dënimit , duke marr për bazë rrethanat të cilat e kanë pruar të përmendurinq te kryej veprat penale

Po ashtu Prokurori i shtetit lexohen aktakuzën PP/II nr. 1807/21 dt. 09.03.2022, me ç rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës .sa i përket të akuzuarve A. Gj. dhe S. M.

I akuzuari A. Gj. , duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin tim av. Genc Juniku, e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, përveç faktit se këtë veprë penale e kam kryer vetëm e jo siç kam deklaruar në st. policor se gjësende mi ka sjellë S. M., pra këtu i akuzuari S. M. nuk ka të bëjë fare me këtë veprë penale ,shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer ,kërkojë faljen nga këtu i dëmtuari M. Zh.për demin e shkaktuar ,edhe pse gjësendi i vjedhur i është kthyer të dëmtuari , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , andaj i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , premtimi se në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm dhe nuk do të përsëris një veprim të tillë , të me shqiptojë një dënim me të butë.

Mbrojtësi av. Genc Juniku, deklaroi se e mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im për veprën penale të kryera ,të cilën pranim i njëjti e bere pa kanosje apo ndërhyrje por me vet iniciativ duk e i ditur edhe me par pasojat dhe favoret e pranimi të fajësisë .I propozoi gjykatës qes me rastin e caktimit llojit dhe lartësisë së dënimit të njëjtit ti shqiptojë një dënim me të butë i cili kishte me arrit qëllimin e dënimit , duke marr për bazë rrethanat të cilat e kanë pruar të përmendurinq te kryej veprat penale

I akuzuari S. M., duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën pandehet me qene se siç kam deklaruar edhe në st .policor ,unë nuk kam të bëjë fare me këtë veprë penale .

Mbrojtësi av. Genc Juniku, deklaroi se e mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im për veprën penale të kryera ,të cilën pranim i njëjti e bere pa kanosje apo ndërhyrje por me vet iniciativ duk e i ditur edhe me par pasojat dhe favoret e pranimi të fajësisë .I propozoi gjykatës qes me rastin e caktimit llojit dhe lartësisë së dënimit të njëjtit ti shqiptojë një dënim me të butë i cili kishte me arrit qëllimin e dënimit , duke marr për bazë rrethanat të cilat e kanë pruar të përmendurinq te kryej veprat penale

I dëmtuari M. Zh., gjatë shqyrtimit fillestar deklaroi se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me që sendet e vjedhura me janë kthyer .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Anton Hasanaj ,deklaroi se sa i përket aktakuzës me nr. PP/II nr. 1807/21 ,e cila i ngarkon dy të pandehurit A. Gj. dhe S. M. ,pas deklarimit të tyre gjatë këtij shqyrtimi fillestar si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të serishëm të shkresave të lëndes deklaroi se tërhiqem nga aktakuza dhe ndjekja penale sa i përket të pandehurit S. M., për shkak të veprës penale vjedhje në bashkëkryerje nga neni 313/1 -31 të KPRK-së, sepse kjo aktakuzë është ngritur kryesisht duke u bazuar në deklarimin e të pandehurit A. Gj. , i cili në deklarimin e tij të dhënë në polici e ka përfshirë edhe të pandehurin S. M., mirëpo bazuar edhe në çështjen penale PP/II nr. 332/22 , ku të dyshuar kanë qene A. Gj. dhe S. M., për veprë të njëjtë penale si dhe me të njëjtat prova fajësuese dhe shfajësuese nga ana e e prokurorit të shtetit është hedhur kallëzimi penale sa i përket të pandehurit S. M. ,prandaj bazuar në të lartcekurat sa i përket të pandehurit S. M. tërhiqem nga aktakuza ndërsa lidhur me pranimin e fajësisë të bere nga i pandehuri A. Gj. ,deklaroi se nuk e

kundërshtojë pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij si dhe pranimi i fajësisë për dy pikat e aktakuzave ka mbështetje të plote edhe në provat që gjenden në shkresë të lëndës. Prandaj gjykatës i propozoi që bëjë pranimin e fajësisë dhe të akuzuarit të shqiptojnë një dënim meritor konform ligjit, duke vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese të vlerësoj faktin se i njëjti është i dënuar për vepra të njëjtat penale

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. Gj. : **I.-me dt.28-29.03.2021, në kohë të pacaktuar, në Gjakovë në rr.“. . .”**, me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë së huaj për vetë, i'a merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit B.B. nga Gjakova, në atë mënyrë që i pandehuri ditën kritike shkon në punëtorinë e të dëmtuarit dhe duke shfrytëzuar mos prezencën e askujt, depërton brenda dhe nga aty vjedh pajisje të punës, konkretisht një fleks “Dewalt”, prodhim USA, burma shinë dhe një akumulator, e më pas largohet nga aty pa u vërejtur nga askush, me ç ‘rast me dt.30.03.2021, nga ana e zyrtareve policor një fleks dhe burma shinë sekuestrohen tek dëshmitari V. B. dhe të njëjtat i kthehen të dëmtuarit, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton dëm në vlerë prej 63 Euro. **-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e nga neni 313 par.1 të KPRK-së., dhe II. - Gjatë muajit Mars të vitit 2021 në kohë të pacaktuar në Rr.”. . .” në Gjakovë**, në bashkëveprim me njëri tjetrin e me qëllim që vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë marrë sendin e luajtshëm pronë e të dëmtuarit M. Zh., në atë mënyrë që të pandehurit pasi kanë ndarë rolet mes veti dhe kanë shkuar në vendin e lartë cekur, e vërejnë veturën e tipit . . .kadet, ngjyre e kuqe, me targa . . . , e cila nuk kishte qenë e mbyllur me qelës dhe të njëjtit pasi afrohen e hapin bagazhin e veturës dhe aty marrin një mjet të punë – burma shinë të tipit Rockwel në vlerë prej 80 Euro, ndërsa ky mjet më pas sekuestrohet nga policia dhe me datë 16.04.2021 i kthehet të dëmtuarit. **- me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e nga neni 313 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin e dytë vullnetarisht ka pranuar fajësinë për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se të akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 të KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit A. Gj. , gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti edhe me parë ka qenë i dënuar me dënim me burgim për vepra penale të natyrës së njëjtë e po ashtu edhe me Aktgjykimin të plotë të plotfuqishëm kësaj gjykate P.nr. 295/21 dhe P.nr.366/21, është në vuajtje të dënimit me burgim për vepra penale të natyrës së njëjtë. Ndërsa prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: moshën e tij, është baba i 2 fëmijëve, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë për veprat penale

për të cilat ngarkohet, pendimin e thellë të shprehur për veprat penale të kryera për shkak të gjendjes ekonomike duke iu kërkuar publikisht falje palëve të dëmtuara ,faktin se është i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike , deklarata e të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi pasi ju janë kthyer gjësendet e vjedhura tl. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera posaçërisht rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 72 të KPRK-së dhe ka aplikuar dispozitën e nenit 72 par.1 nënpar.1.6 të KPRK-së ,kur ka shqiptuar dënimin unik me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së me bindje se ky dënim të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi e shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimit të ligjit .

Sa i përket të akuzuarit S. M. , i akuzuar për veprën penale vjedhë në bashkë kryerje nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr. 1807/21 të datës 09.03.2022 ,pasi që Prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit Gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 te KPP-ës, pasi që gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur që ta saktësojë lartësinë e dëmit që i akuzuari iu ka shkaktuar te dëmtuarve pasi që nuk ka asnjë ekspertize apo konstatim për lartësinë e dëmit të shkaktuar .

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € ,është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.96/22, 105/22 datë 06.07.2022**

**Sekretarja juridike  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej 15 ditësh ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate.